

Koha për një treg kapitali

ERSUIN SHEHU

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z.Ervin Koçi flet për "SCAN Magazine" rrëth sfidave të zhvillimit të tregjeve financiare në vend. Pritshmëritë nga bursa e titujve dhe rëndësia e zhvillimit të një tregu kapitali për ekonominë shqiptare. Si mund të nxiten segmentet e tjera të tregut financiar nga zhvillimi i bursës dhe përmes incentivave të mëtejshme ligjore.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) do të mbështesë ngritjen e një tregut të shëndetshëm kapitali në Shqipëri. Në një intervistë për "Scan Magazine" Ervin Koçi, drejtor i përgjithshëm ekzekutiv i AMF, shprehet se zhvillimi i tregut kapitalit do të ishte një shtysë e rëndësishme për rritjen ekonomike afatgjatë të vendit. Sipas tij, një treg funksional kapitali është një mekanizëm i rëndësishëm për zhvillimin financier dhe ekonomik, duke ndihmuar në zhvillimin e instrumenteve të reja financiare, duke shërbyer si një formë alternative financimi për kompanitë. Ai mendon se zhvillimi i tregut të titujve i jep mundësi zhvillimit zinxhir të tregut financiar edhe në segmente të tjera, si fondet e investimit apo fondet private të pensioneve. Sipas tij, obligacionet e shoqërive aksionare janë një segment potencial i zhvillimit të tregut të titujve, duke marrë në konsideratë edhe numrin e kompanive të mëdha që operojnë në sektorin financier, energjetik, telekomunikacionit etj, duhet theksuar se ekzistojnë potenciale për rritjen e numrit të emetuesve të tjerë në treg.



e numrit të emetuesve të tjerë në treg. Në verën e këtij viti, AMF licencoi të parën bursë me kapital privat në historinë e tregut finanziar shqiptar. Zoti Koçi shprehet se ekzistencia e një tregu të organizuar, i ndihmon bizneset për akses në burime të reja të kapital-

Tregu i titujve, ose Bursa, veçanërisht tregu i kapitaleve është një mekanizëm i rëndësishëm për zhvillimin financier dhe ekonomik, duke ndihmuar në zhvillimin e instrumenteve të reja financiare



it, në kushtet e një mjedisi me norma të ulëta interesit.

Sipas tij, rritja e konkurrencës në ekonominë shqiptare do të nxisë bizneset të listohen në bursë në funksion të përmirësimit të imazhit të tyre për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut. Nga ana tjetër, ai theksон se Autoriteti do të jetë shumë i kujdeshëm dhe i vëmendshëm për të monitoruar çdo veprim të Bursës për të ofruar garanci dhe transparencë maksimale për investitorët.

Pas përvjojës së pasuksesshme të bursës me kapital shtetëror, këtë verë ju licencuat të parën bursë private në tregun finanziar shqiptar. Pse besoni se ky projekt do të jetë i sukseshëm dhe do t'i mundësojë ekonomisë për herë të parë një treg funksional të kapitalit?

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e licencoi bursën e parë shqiptare me kapital privat si një



domosdoshmëri për rritjen e alternativave të investimit si dhe formalizimin e ekonomisë dhe transparencës së bizneseve. Licencimi i Bursës Shqiptare të Titujve u miratua pas plotësimit të kërkesave ligjore dhe rregullative.

Ekzistenza e një tregu të organizuar, siç është bursa, i ndihmon bizneset për akses në burime të reja të kapitalit, në kushtet e një mjedisi me norma të ulëta interesit për depozitat bankare dhe me politika shtrënguese përsa i përket kredidhënies. Gjithashtu, rritja e konkurrencës në ekonominë shqiptare do të nxisë bizneset të listohen në bursë në funksion të përmirësimit të imazhit të tyre për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut. Krahasuar me vite më parë, interesit i kompanive për të emetuar letra me vlerë është rritur, edhe pse deri tani ka patur zhvillime vetëm në drejtim të emetimit të obligacioneve me ofertë private për investitorët, ak-

sionerët e tyre apo individë. Mendoj se obligacionet e shoqërive

akcionare janë një segment potencial i zhvillimit të tregut të titujve.

Duke marrë në konsideratë edhe numrin e kompanive të mëdha që operojnë në sektorin financier, energjetik, telekomunikacionit etj, duhet theksuar se ekzistojnë potenciale për rritjen e numrit të emetuesve të tjerë në treg.

Mendoj se është koha që edhe Shqipëria të jetë pjesë e këtij zhvillimi të ri për të qenë në të ardhmen e integruar në tregjet rajonale dhe evropiane. Në anën tjetër, duhet të theksoj se Autoriteti do të jetë shumë i kujdeshëm dhe i vëmendshëm për të monitoru-

Rritja e konkurrencës në ekonominë shqiptare do të nxisë bizneset të listohen në bursë në funksion të përmirësimit të imazhit të tyre për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut. Krahasuar me vite më parë, interesit i kompanive për të emetuar letra me vlerë është rritur, edhe pse deri tani ka patur zhvillime vetëm në drejtim të emetimit të obligacioneve me ofertë private për investitorët, ak-



“Mendoj se nismat për të shtuar përfshirjen e qytetarëve në fondet e pensioneve private vullnetare në një kuadër afatgjatë do të kontribuojnë në reduktimin e varfërisë dhe pasojave sociale, pasi aktualisht skema e pensioneve vlerësohet si një peshë shumë e madhe për buxhetin e shtetit”

ment tjetër eshtë se bursa ofron mundësinë e financimit afatgjatë të projekteve të biznesit dhe Qeverisë, pra, mbështet rritjen ekonomike në terma afatgjatë. Përfshirja e sa më shumë aktorëve në tregun e titujve krijon mundësi për rritjen e likuiditetit të këtij tregu dhe rrjedhimisht sjell një vlerësim më real të instrumenteve financiare. Për më tepër, zhvillimi i tregut të titujve i jep mundësi zhvillimi industrisë së fondeve të investimit dhe fondeve te pensionit. Bursa nëpërmjet sistemit të tregimit dhe rregullave të saj krijon mundësi për një tregim eficent, të shpejtë, transparent,

të paanshëm dhe me kosto të ulët ndërmjetësimi. Ky ambient nxit investitorët të investojnë kursimet e tyre me besimin tek një treg transparent dhe i drejtë që eshtë i mirëregulluar. Ne do të vlerësonim që pjesëtarë të Bursës të ishin edhe institucione prestigjoze ndërkombëtare, gjë që do të sillte eksperiencën e tyre nga tregjet më të zhvilluara, por në të njëjtën kohë do të rriste besimin tek investitorët.

Besoni se tregu shqiptar ka tashmë korporata me pjekurinë dhe standartet e nevojshme për të tregtuar titujt e tyre në bursë?

Kompanitë me performancë

të mirë dhe me standarde nuk i mungojnë tregut shqiptar. Këto kompani kanë nevojë vazhdimisht për fonde, të cilat mund të realizohen nëpermjet emetimit të titujve, fillimisht obligacioneve, si një instrument më i preferuar nga biznesi dhe më tej me akcionë. Veç të tjerash, besoj se fillimi i funksionimit të Bursës do të shtojë edhe konkurrencën mes kompanive për të arritur standarde sa më të larta profesionale dhe financiare.

Në vitet e fundit, tregu finanziar ka vuajtur problemi i ndërmjetësve të palicencuar për investime në platformat online. Besoni se funksioni ligjor i AMF-së quhet i përbushur vetëm në raportimin e subjekteve të palicencuara te organet e tjera ligjzbatuese? A ka detyrë AMF, sipas jush, të ndjekë procesin derisa të jetë siguruar që aktiviteti i këtyre subjekteve të ndërpritet?

Më duhet të theksoj që në fil-

lim se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, mbikëqyr dhe rregullon vetëm subjektet e licencuara. Në anën tjetër, Autoriteti në mënyrë të vazhdueshme ka informuar investitorët që të tregohen shumë të kujdeshëm përpëra çdo vepimi që ndërmarrin për investime në platforma të palicencuara, për shkak të rrezikut të madh për humbje të investimit. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit financier të publikut është pjesë thelbësore e strategjisë për mbrojtjen e konsumatorit që ka nisur të zbatohet, me qëllim kryesor informimin dhe mbrojtjen e tij. Përsa i përket subjekteve të palicencuara, janë një sërë organesh të tjera ligjzbatuese që në bashkëpunim me njeri-tjetrin adresojnë këto problematika. Në këtë drejtim, ka patur raste, siç ishte ai i shoqërisë “FxLider”, që AMF e ka raportuar në organet kompetente. Do të ftoja gjithashtu qytetarët, edhe mediat, që të denoncojnë pranë autoriteteve ligjzbatuese çdo rast kur konstantojnë subjekte të tilla, pasi kemi të bëjmë jo vetëm me shkelje të ligjit, por edhe me një rrezik shumë të madh për qytetarët, që mund të bien pre e spekulimeve në treg.

Fondet e investimit, veçanërisht në vitet e para, janë zhvilluar më shpejt se kuadri rregulator dhe mbikëqyrës. Besoni se tani kuadri ligjor dhe kapacitetet e AMF garantojnë një mbikëqyrje efektive të këtij tregu? Shihni hapësira për të zgjeruar spektrin e produkteve për fondet e investimit në lekë, për të garantuar kthime më të larta për investitorët dhe për të diversifikuar portofolin e aktiveve?

rritjen e aftësive profesionale të stafit të Autoritetit. Bazuar në objektivat e kësaj faze janë duke u draftuar dy projektligje, përfondet e investimit dhe letrat me vlerë, rregullore të ndryshme që lidhen me fushën e fondeve të investimit dhe të letrave me vlerë, si dhe raporte që lidhen me zhvillimin e tregut të obligacioneve dhe procesit të emetimit të tyre. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregulator do t'i shërbejë zhvillimit të fondeve të investimit dhe tregut të obligacioneve të korporatave dhe atyre bashkiane, duke sjellë gjithashtu edhe një përafrim me legjislacionin e BE-së dhe standartet më të mira ndërkombëtare. Përsa i përket pjesës së dytë të pyetjes suaj, kthimi më i lartë i investimit, ka në anën tjetër risk më të lartë. Autoriteti është më shumë i interesuar që investitorët të janë sa më të mbrojtur dhe të ofrohen produkte sa më transparente për ta.

Fondet e pensioneve private ngelën jashtë reformës së pensioneve, si një kolonë kontributi të detyrueshëm. Besoni se kontributi në këto fonde ka incentiva të mjafueshme ligjore dhe fiskale? A ka AMF propozime për t'i zgjeruar më tej këto incentiva?

Me konsulencën e Bankës Botërore, ne kemi propozuar amendime të ligjit bazë përfondet e pensionit vullnetar, që synojnë të rregullojnë jo vetëm mbikëqyrjen më të mirë të tyre, por edhe rritjen e transparencës, informimit dhe edukimit financier të publikut në lidhje me dobinë e këtyre fondeve. Ato janë depozitar në Ministrinë e Financave, si institucioni që ka kompetencat përfi propozuar Kuvendit ndry-



“Kompanitë me performancë të mirë dhe me standarde nuk i mungojnë tregut shqiptar. Këto kompani kanë nevojë vazhdimisht përfondet, të cilat mund të realizohen nëpermjet emetimit të titujve, fillimisht obligacioneve, si një instrument më i preferuar nga biznesi dhe më tej me akcionë. Veç të tjerash, besoj se fillimi i funksionimit të Bursës do të shtojë edhe konkurrencën mes kompanive për të arritur standarde sa më të larta profesionale dhe financiare”

66

Ne po punojmë, gjithashtu, për t'i dhënë një rrugëzgjidhje problemeve të mbartura, siç është ai me Fondin e Kompensimit. Brenda vitit 2018, jemi angazhuar që të mos kemi asnjë pagesë të prapambetur për periudhat 2002-2016

”

shime ligjore apo projektligje. Në dijeninë tonë, propozimet janë duke u diskutuar në Ministrinë e Financave, për t'ia përcjellë më pas kalendarit të punimeve të Kuvendit. Amendimet e propozuara nga Autoriteti kanë të bëjnë me zbatimin e mbikëqyrjes me bazë risku, rritjen e transparencës në informimin para nënshkrimit të kontratës dhe në vijim, krijimin e strukturave dhe parashikimit të procedurave nga ana e shoqërive administruuese për trajtimin e ankesave, etj.

Në anën tjeter, disa ndryshime ligjore të bëra në vitin 2014 krijuan disa lehtësi për këto fonde, duke i përjashtuar nga tati-mi kontributet përfundimtare e pensionit vullnetar. Gjithashtu edhe kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensioneve përjashtohen nga tati-mi, ndërsa përfitimet e anëtarit i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale. Ky sistem tati-mor përfundet private të pensionit, i njohur si EET, aplikohet edhe në pjesën më të madhe të vendeve evropiane. Megjithë nismat e ndërmarrja, kemi të bëjmë me një treg ende të brishtë, pak të zhvilluar, prandaj nevojitet më shumë ndërgjegjësim dhe përpjekje të përbashkëta të disa ak- lligjave përfundimtare të pensionit vullnetar, i cili ndalon investimet e tyre në veprimtari me risk. Gjithashtu, ligji parashikon edhe mbrojtjen e aseteve të anëtarit, pasi ato nuk mund të jenë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe përfundimtare të kreditorëve të shoqërisë administrative të fondit të pensionit. Grupi i aseteve të fondit të pensionit është në pronësi vetëm të anëtarëve të fondit. Këto aspekte ligjore janë parashikuar në funksion të mbrojtjes së anëtarit të fondit, por asnjëherë nuk mund të përjashtohet mundësia e riskut të tregut, riskut të inflacionit, etj. Megjithatë fondet private të pensionit janë një alternativë e mirë përfundimtare, që individit të sigurojë një pension të mjaf-

torëve, përfshirë këtu edhe mediat, në aspektin e informimit, promovimit dhe zgjerimit të pjesëmarrjes në këto fonde.

Mendoni se fondet e pensioneve private do të zhvillo-heshin më shumë, në rast se do të përfshiheshin në një skemë sigurimi, e ngjashme me atë të depozitave?


kontratës dhe në vijim, krijimin e strukturave dhe parashikimit të procedurave nga ana e shoqërise administruuese për trajtimin e ankesave, etj.

Në anën tjeter, disa ndryshime ligjore të bëra në vitin 2014 krijuan disa lehtësi për këto fonde, duke i përjashtuar nga tati-mi kontributet për fondin e pensionit vullnetar. Gjithashtu edhe kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit

Fondet e pensionit vullnetar të licencuara në Shqipëri janë fonde me kontribute të përcaktuara dhe janë të rregulluara sipas ligjit bazë për fondet e pensionit vullnetar, i cili ndalon investimet e tyre në veprimtari me risk. Gjithashtu, ligji parashikon edhe mbrojtjen e aseteve të anëtarit, pasi ato nuk mund të janë objekt i pretendimeve ose ekzekutimeve, të kryera në emër dhe për llogari të kreditorëve të shoqërisë administruuese të fondit të pensionit.

të pensioneve përjashtohen nga tatimi, ndërsa përfitimet e anëtarit i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat personale. Ky sistem tatumor përfondet private të pensionit, i njohur si EET, aplikohet edhe në pjesën më të madhe të vendeve evropiane. Megjithë nismat e ndërmarra, kemi të bëjmë me një treg ende të brishtë, pak të zhvilluar, prandaj nevojitet më shumë ndërgjegjësim dhe përpjekje të përbashkëta të disa ak-

Grupi i aseteve të fondit të pensionit është në pronësi vetëm të anëtarëve të fondit. Këto aspekte ligjore janë parashikuar në funksion të mbrojtjes së anëtarit të fondit, por asnjëherë nuk mund të përjashtohet mundësia e riskut të tregut, riskut të inflacionit, etj. Megjithatë fondet private të pensionit janë një alternativë e mirë për të plotësuar të ardhurat përfension me qëllim që individi të sigurojë një pension të mjaf-



tueshëm që ndihmon në ruajtjen e një standardi të mirë jetese në moshën e pensionit.

Nisur nga praktikat e vendeve të tjera të BE-së, që kanë më shumë eksperiencë në këtë fushë, mendoj se duhen ndërmarrë nisma, edhe në kuadër të ndryshimeve ligjore të nisura tashmë nga Autoriteti, për ta rregulluar më mirë këtë treg dhe mbi të gjitha për të rritur numrin e anëtarëve që investojnë në këto fonde pensionesh vullnetare. Mendoj se nismat për të shtuar përfshirjen e qytetarëve në fondet e pensioneve private vullnetare në një kuadër afatgjatë do të kontribuojnë në reduktimin e varférise dhe pasojave sociale, pasi aktualisht skema e pensioneve vlerësohet si një peshë shumë e madhe për buxhetin e shtetit.

Cila është strategja e AMF për një mbikëqyrje sa më efektive të tregjeve dhe për zhvilimin e mëtejshëm të tyre? Çfarë po bëhet në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit dhe zgjidhjen e problematikave të mbartura ndër vite, siç është rasti i fondit

të kompensimit:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është i fokusuar jo vetëm në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve financiare, por në zhvillimin e kujdeshëm të tyre, në mënyrë që ato të japid ndikim të qëndrueshëm edhe në tritien ekonomike të vendit. Por edhe perspektivën e zhvillimit tyre në të ardhmen. Me qëllim rjen e përgjegjësive reale dhe rrethorë, si garantues i të drejtave interesave të konsumatorëve, strukturën e re organizative, krijuar një drejtori të posaçmarrës së përgjegjësve.

Autoriteti ka nisur të zbatojë strukturën e re organizative, të konsultuar me partnerët tanë ndërkombëtarë, e cila reflekton më së miri jo
mbrojtjen e konsumatorit dhe pë edukimin financiar të tij. Gjithashtu, në muajin tetor kemi nisur zbatim e strategjisë për rrithjen e besimit



“

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është i fokusuar jo vetëm në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve financiare, por në zhvillimin e kujdeshëm të tyre, në mënyrë që ato të japid ndikim të qëndrueshëm edhe në rritjen ekonomike të vendit

”

konsumentorit dhe investitorit me orë të hapura leksionesh në disa universitete, që do të pasohen nga aktivitetet e tjerat e planifikuarat.

Ne po punojmë gjithashtu për t'i dhënë një rrugëzgjidhje problemeve të mbartura, siç është ai me fondin e kompensimit. Brenda vitit 2018, jemi angazhuar që të mos kemi asnjë pagesë të prapambetur përiudhat 2002-2016.

Gjithashtu, pranë Auto-rititetit të Mbikëqyrjes Financiare është ngritur një Komitet Këshil-limor për hartimin e strategjisë 5-vjeçare të zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Komiteti Këshil-limor po bashkëpunon me strukturat e përhershme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Ministri-në e Financave, Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën e Shqipërisë, tregjet nën mbikëqyrje dhe shumë aktorë të tjera për të përcaktuar një program të veprimeve, nismat ligjore dhe nënligjore për zhvillimin e tregjeve dhe për të qëndruar sa më pranë konsumatorit. ■